



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 212, Datë 27.06.2023

MBI

**MIRATIMIN E “UDHËZUESIT PËR TESTIMIN E TREGUT PËR GAZSJELLËSIN
TRANS ADRIATIK”**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 13, 15, pika 1, gërma “a”; 16, pika 24 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë” (Opinionit Përfundimtar i Përbashkët), Korrik 2013; Opinionit 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 Maj 2013, “Mbi përjashtimin e ndërlidhësit TAP AG, nga kërkesa të caktuara sipas Direktivës 2009/73/EC nga Autoriteti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë”, Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/459 e datës 16 mars 2017 “Për vendosjen e një kodi rrjeti për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e Rregullores (BE) Nr. 984/2013” (Mekanizmi për Alokimin e Kapacitetit për Kodin e Rrjetit); vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 103, datë 26.06.2019; “Mbi miratimin e Transpozimit të Rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin nr.2018/06/PHGL-ENC “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”; si dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e datës 27.6.2023, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtorja e Gazit Natyror, me nr. 1839/2 prot., datë 26.06.2023 “Mbi miratimin e “Udhëzuesit për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik”,

Konstatohet se:

Duke patur parasysh:

- Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 13 Korrikut 2009 “Për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55/EC);
- Direktivën (BE) 2019/692 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 17 Prillit 2019 “Për shfuqizimin e Direktivës 2009/73/KE në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”;
- Rregulloren e (BE) 2017/459 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 16 Marsit 2017 (CAM NC) “Për vendosjen e një kodi rrjeti për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e Rregullores (BE) Nr. 984/2013”;
- Rregulloren 2019/942/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 5 Qershorit 2019 “Për tregun e brendshëm të energjisë elektrike”;

- Vendimin e Komisionit Evropian të 16 Majit 2013, që përmban “Përrjashtimin e Gazësjellësit Trans Adriatik nga aksesit i palëve të treta, rregullimin e tarifave dhe ndarjen e pronësisë të përcaktuara në nenet 9, 32, 41(6), 41(8), 41(10) të Direktivës 2009/73/EC;
- Rregulloren 715/2009/Ke të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 13 korrik 2009 “Mbi kushtet e aksesit në rrjetet e transmetimit të gazit natyror dhe shfuqizimin e Rregullores (EC) Nr. 1775/2005”;
- Paragrafin 4.1.7 të Opinionit të Përbashkët, ku TAP AG duhet rregullisht (të paktën çdo dy vjet) të kryejë një Testim Tregu me qëllim që t’u ofrojë të gjitha palëve të interesuara kapacitetet shtesë derisa të arrihet mundësia maksimale e zgjerimit të tubacionit;
- Testimi i Tregut, i referuar në paragrafin e mëparshëm, duhet të kryhet në përputhje me Udhëzimet e miratuara bashkarisht nga Autoritetet Rregullatore të Energjisë, konkretisht Shqiptare (ERE), Greke (RAE) dhe Italiane (ARERA).
- Në datën 29 Gusht 2011, TAP AG paraqiti në Ministrinë Italiane të Zhvillimit Ekonomik dhe në datën 31 Gusht 2011 paraqiti tek Autoriteti Rregullator i Energjisë në Greqi (RAE) “Aplikimin e Përrjashtimit për Gazsjellësin Trans Adriatik” si parashikohet në nenin 36 të Direktivës së Gazit 2009/73/EC. Në datën 1 Shtator 2011 TAP AG paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë (ERE) “Aplikimin e Përrjashtimit të Gazsjellësit Trans Adriatik”, sipas nenit 22 të Direktivës së Gazit 2003/55/EC.
- Në Qershor 2013 Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Italisë, RAE dhe ERE morën vendimin për përrjashtimin e *ndërlidhësit TAP AG, nga kërkesa të caktuara sipas Direktivës 2009/73/EC*, duke miratuar *Opinionin Përfundimtar të Përbashkët*, një dokument i shkruar në mënyrë të përbashkët nga ARERA, ERE dhe RAE (këtu dhe më poshtë: “Autoritetet” dhe e ndryshuan për t’u përputhur me Vendimin e Komisionit [C(2013)2949 përfundimtar] datë 16 Maj 2013 duke marrë parasysh Opinionin 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 14 Maj 2013.
- Në datën 16 Mars 2017, u miratua Rregullorja e re e BE 459/2017 “Për krijimin e Kodit të Rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapacitetit tek sistemet e transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e Rregullores së (BE) nr 984/2013”. Rregullorja e BE 2017/459 (këtu dhe më poshtë CAM NC) krijon një Kod Rrjeti ku përcaktohen mekanizmat për alokimin e kapacitetit në sistemet e transmetimit të gazit për kapacitetin ekzistues dhe kapacitetin në rritje.
- Në datën 16 Qershor 2023, në përputhje me Paragrafin 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP AG u ka paraqitur Autoriteteve “*Udhëzimet e vitit 2023 për Testimin e Tregut të Gazsjellësit Trans Adriatik*” (këtu dhe më poshtë: “*Udhëzimet 2023*”).

Gjithashtu duke patur parasysh:

- *Udhëzimet 2023* të propozuara, sikurse përmbledhur më lart, janë në përputhje me parimet e deklaruara në Opinionin e Përbashkët Përfundimtar, në CAM NC, në të gjitha legjislacionet kombëtare dhe nuk paraqesin barriera të panevojshme në procesin e parashikuar për ndërtimin e kapaciteteve shtesë.
- Procesi është projektuar në atë mënyrë që të lehtësojë bashkëpunimin me OST-të fqinje, me synimin për të siguruar një zhvillim të koordinuar të rrjetit, duke shmangur mospërputhjet e mundshme në ndërtimin e kapaciteteve ndërkufitare; *Udhëzimet 2023* marrin parasysh nevojën për të siguruar koordinimin e duhur me Testimin e Tregut 2021 ende të hapur.

- OST-të janë ende duke vlerësuar mundësinë e përfundimit me një raund të dytë ofertash detyruese që mund mund të zhvillohen ndërmjet fundit të vitit 2023 dhe fillimit të vitit 2024 për Testin e Tregut. Udhëzimet 2023 parashikojnë koordinimin e kohës në mënyrë që caktimi i detyrueshëm i kapacitetit të bëhet pasi të përfundojë faza e dytë e detyrimit të procedurës së mëparshme të nisur në vitin 2021.
- Dokumentin e datës 16 qershor 2023 që TAP AG dërgoi “Udhëzimet e Testimit të Tregut 2023” (Shtojca B e kësaj dispozite) në lidhje me ekzaminimin e ofertave të reja të mundëshme të kapacitetit në rritje për Autoritetet për miratim.
- Autoritetet, pas analizimit të “Udhëzimit të Testimit të Tregut 2023”, i cili në thelb përfshin të njëjtat parime të ndjekura për Testimin e Tregut 2021, së bashku zhvilluan një dokument që përmban vendimin e miratimit dhe arsyet përkatëse (Shtojca A) e këtij vendimi;
- Dokumenti i përbashkët është objekt miratimi edhe nga Rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE.
- Procedura e testit të tregut 2023 e propozuar nga TAP AG është në përputhje me parimet e paraqitura në Opinionin e Përbashkët Përfundimtar dhe me Direktivat e Rregulloret Evropiane për alokimin e kapacitetit ekzistues dhe rritës.
- Nevoja e miratimit të dokumentit të përbashkët që aprovon “Udhëzimet e Testimit të Tregut 2023” (Shtojca A).
- Nevojshmërinë që shtojcat e kësaj dispozite (Shtojca A dhe Shtojca B) të mbahen konfidenciale të paktën deri në fillimin e Testimit të Tregut 2023 pasi dokumenti i miratuar “Udhëzuesi për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2023” do të publikohet nga TAP AG në faqen e saj në datën e fillimit të Testimit të Tregut.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë “Udhëzuesin për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2023” dokumenti i paraqitur nga TAP AG më 16 Qershor 2023 (Shtojca B), si edhe të shprehet në vendimin e përbashkët me Rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE (Shtojca A).
2. Të dërgojë një kopje të këtij vendimi Autoriteteve Rregullatore ARERA dhe RAE, kompanisë TAP AG; si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
3. Të publikojë këtë vendim në faqen e internetit të ERE, www.erealb@ere.gov.al, (vendimin pa anekset A dhe B).
4. Të publikojë anekset A dhe B në faqen e internetit të ERE-s pasi TAP AG ka publikuar *Udhëzuesin për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2023* në faqen e saj të internetit.
5. Versioni në gjuhën e origjinës (Anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit Shqip.

6. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë shoqërinë TAP AG, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rregullatorin e Italisë ARERA dhe Rregullatorin e Greqisë RAE, për vendimin e bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI